



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr.88, datë 24.04.2023

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR ANALIZIMIN E AFTËSIVE  
PROFESIONALE TË PROKURORIT SAIMIR HYSA

Bazuar në nenin 179/b dhe në nenin “E”, të Aneksit “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 40 dhe 42, pika 1, të ligjit Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit Nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me raportin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit kalimtar, prokurorit **Saimir Hysa**, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Një kopje e këtij Raporti i dërgohet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë më datë 24.04.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Eloida Goxhi

ANËTAR  
Mirela Bogdani

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ANËTAR  
Arta Mandro

ZV/KRYETAR  
Tartar Baza

ANËTAR  
Nurihan Seiti

ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Ledina Riza

